



Pranuar / Donesha / Puniljena / Prilaz / Received / Dated	30.04.2021	1	viti and year
Organ / Repesia / Organ / Représenta / Org. / Jllm	SKM/MPMS	2149/2021	116
Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.243/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2257/19 të datës 23.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.400/2019 të datës 15.07.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi fshati Drenoc Komuna e Malishevës, kundër organit të punësimit- Inspektorati i Punës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 29.04.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.400/2019 e datës 15.07.2019, e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.2095 i datës 06.06.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- III. Anulohet procedura e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin Rajonal në Prishtinë" dhe të gjitha veprimet që kanë rrjedh nga kjo procedurë.
- IV. Obligohet Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës së Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Inspektorati i Punës/ MPMS, me datë 22.03.2019 ka shpallur konkursin e brendshëm për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim në Rajonin e Prishtinës" në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Me datën 19.04.2019 Inspektorati i punës ka nxjerrë njoftimin për kandidatin e përzgjedhur.

I pakënaqur me njoftimin e datës 19.04.2019 për kandidatin e suksesshëm, ankuesi më datë 20.05.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me vendimin e datës 06.06.2019 me Nr.2095 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi kundër Vendimit Nr.2095 të datës 06.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, më datë 15.07.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3150/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.07.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës/MPMS. Inspektorati i Punës /MPMS më datë 30.07.2019, me nr.prot.841/2019 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e procedurës së zhvilluar në lidhje me këtë lëndë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri në tetor 2020, ku më datë 08.10.2020 janë zgjedhë 5 anëtar të këshillit ndërsa më datë 14/10/2021 janë themeluar edhe kolegjet profesionale, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 06.09.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 24.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2257/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 06.09.2019, duke kthyer në KPMSHCK-lëndën për vendosje.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 3150/2019 të datës 15.07.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me nr.2095 i datës 06.06.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale; Vendimi me nr.21/2019 i datës 29.03.2019 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës; Kopja e testit me shkrim i datës 12.04.2019; Regjistri i aplikacioneve të pranuar i datës 22.03.2019; Regjistri i aplikacioneve të cilat kanë hyrë në listën e shkurtër dhe ato që nuk kanë hyrë në listën e shkurtër e datës 02.04.2019; Përmbledhja e Vlerësimeve individuale ; Përcaktimi i Kritereve për përfshirjen në listën e ngushtë e datës 01.04.2019; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Kopja e konkursit e datës 22. 03.2019; Autorizimi i MAP-it; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 19.04.2019; Kërkesa për punësim për bashkë me dokumentet e kërkuara; Kërkesa për punësim për bashkë me dokumentet e kërkuara dhe Përgjigje në ankesë e datës 30.07.2019 me numër protokollit 3372/2019 bashkë me shkresat e lëndës; Aktgjykimin

A.nr.2257/19 të datës 23.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Njoftimin e datës 06.09.2019 për ankuesin.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon: që procedura e rekrutimit nuk është zhvilluar nga menaxheri i personelit, në dosje të lëndës nuk ka formuar MAP-SHCK-07 dhe 07A, kandidati i suksesshëm nuk ka 5 vite përvojë pune sepse nuk ka ofruar vërtetim të përvojës së punës apo kontratë pune por vetëm dëshmi nga trusti; tek vlerësimi i testit me shkrim nuk janë vendosur pikët në test me shkrim, kështu që kandidati i suksesshëm është favorizuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që procedura e rekrutimit nuk është zhvilluar nga menaxheri i personelit, ka konstatuar që më datë 22.04.2021 kemi dërguar e-mail tek Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës dhe Zyrtarja e Lartë për Personel me të cilin kemi kërkuar provat: *"Autorizimin nga Kryeinspektori me të cili z. është i obliguar me i udhëheq procedurat e rekrutimit; Dëshminë e përvojës së punës së kandidatit Ahmet Delolli në FINCA nga 2009-2014; Kërkesën për fillimin e procedurës së rekrutimit; Formularin FORMSHCK-07 dhe FORMSHCK-07A; Testet me shkrim të kandidatit dhe ankuesit ku janë të vendosura edhe pikët për secilën përgjigje"*, ndërsa Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës më datë 26.04.2021 me shkresë zyrtare përgjigjet se *"sa i përket pikës 1 të kërkesës suaj... ju njoftojmë se në shkresat e lëndës (dosja konkursit) por as në evidencat e Inspektoratit të Punës një autorizim i tillë nuk ekziston. Po ashtu në shkresat e lëndës (dosjen së konkursit nuk ka kërkesë për fillimin e procedurës, gjithashtu nuk ka as formular Form.SHCK 07 dhe FORMSHCK-07A"*.

Meqenëse pretendimi ankimor i ankuesit është që procedura e rekrutimit për pozitën e lartcekur është udhëheqës nga Udhëheqësi i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, edhe pse Inspektorati i Punës nuk ka Menaxher të Personelit, për kemi kërkuar që nëse Udhëheqësi i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme ka pasur autorizim me shkrim nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës për me i udhëheqë procedurën e rekrutimit.

Bazuar në provat e lëndës dhe përgjigjen e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse Inspektorati i Punës nuk ka pasur Menaxher të Personelit apo person të autorizuar me shkrim për me udhëheqë këtë procedurë, konsiderohet që udhëheqja e kësaj procedure është në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 përkatësisht nenin 2, 4 dhe 7 të kësaj rregullore nga se njësisë së personelit i janë dhënë përgjegjësi nëpër të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit dhe në këtë aspekt qëndron si i bazuar pretendimi i ankuesit sepse Inspektorati është trupë ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila ministri ka zyrën e personelit funksionale dhe ka qenë dashtë që procedura e rekrutimit të zhvillohet nga kjo zyrë konform Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, andaj ky pretendim ankimor është i bazuar edhe për faktin se komisioni i ankesave ka vendosë që është në kuadër të MPMS-së e jo inspektoratit andaj edhe në të njëjtën formë ka qenë dashtë që të kërkohet nga

zyra e personelit të MPMS-së që të zhvillojë procedurën e rekrutimit në lidhje me këtë konkurs.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, konstaton se për fillimit e procedurës së rekrutimit nuk është përdorur Formulari Form.MAP-SHCK-01 i cili është kusht ligjor sipas neni 9 paragrafit 5 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"për fillimin e procedurës së rekrutimit në përputhje me këtë nen përdoret formulari, Form.MAP-SHCK-01"*.

Neni 33 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ka përcaktuar që Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil vendos për sistemin e notimit i cili përdoret gjatë testimit me shkrim dhe me gojë dhe në këtë fazë përdoren formulari Form.MAP-SHCK-07 ose formulari Form.MAP-SHCK-07a, dhe të gjithë anëtarëve të Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil sigurohet nga një formular, ndërsa duke ju referuar provave të lëndës dhe përgjigjes së datës 26.04.2021 të Kryeinspektorit të Punës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se gjatë procedurës së rekrutimit nuk është përdorur, asnjëri nga këta formular që është në kundërshtim me nenin 33 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil andaj edhe mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se kriteret themelore të konkursit për këtë pozitë kanë qenë: *"Diplome universitare nga fusha e shkencave juridike apo teknike; Pesë (5) vite përvojë pune profesionale"*, ndërsa gjatë shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve respektivisht kandidatit të suksesshëm, vlerëson se kandidati i suksesshëm për këtë pozitë në momentin që ka aplikuar si dëshmi të përvojës së punës ka dorëzuar kontratë pune e lidhur me KDCA për një periudhë 3 mujore nga data 01.05.2016, Kontratë punë e lidhur me FINCA për periudhën 01.02.2014 deri 31.01.2015 po ashtu edhe dëshminë nga Trusti, e cila dëshmi konfirmon përvojën e punës por nuk specifikon natyrën e punës që është kushtë për të vlerësuar elementin përvojës profesionale të paraparë sipas konkursit, mirëpo nuk ka dorëzuar dokumentacion tjetër edhe pse në kërkesën për përgjigje në ankesë dërguar nga organi i punësimit përmes aplikacionit të kandidatit të suksesshëm ka përshkruar që nga data 01.06.2009 deri më datë 30.05.2014 ka qenë i punësuar në IMF FINCA KOSOVA, por që nuk ka dërguar ndonjë kontratë apo vërtetim të përvojës së punës, edhe pse në momentin që aplikohet për një pozitë kandidatët përveç kopjes së diplomës duhet të dorëzojnë kopjen e dëshmisë së punësimit siç parashihet me nenin 21 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ndërsa një nga shkaqet pse aplikacioni refuzohet është kur aplikacionet janë të pasakta dhe të pakompletuara siç parashihet me nenin 25 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Bazuar në këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil gabimisht ka vlerësuar aplikacionet e kandidatëve respektivisht kandidatit të suksesshëm.

Poashtu kolegji mbi bazë të pretendimit ankimor në lidhje me at se komisioni i rekrutimit nuk ka qenë i përbërë konformë rregullores 02/2010, qëndron si i bazuar sepse në nenin 7 paragrafi 5 parashihet se në komision përzgjedhës duhet të jetë një anëtar nga zyra e personelit ndërsa nga vendimi i datës 29/03/2019 me nr.21/2019 në pikën II shihet se në përbërje të komisionit nuk ka asnjë zyrtarë nga zyra e personelit.

Kolegji mbi bazë të pretendimit ankimor se procedura nuk është në harmoni edhe me rregulloren 21/2012 për avancim në karrierë të nëpunësve civil konstaton se ka elemente të mjaftueshme që e argumentojnë faktin se procedura nuk është zhvilluar konformë kësaj rregullore dhe kjo mund të vërtetohet edhe për faktin se nëse shikojmë arsyetimin e Vendimit Nr.2095 të datës 06.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale mund të vërtetohet se me asnjë fjali nuk është argumentuar arsyeshmëria dhe baza ligjore e veprimeve konformë kësaj rregullore, përveç që potencohet në hyrje të arsyetimit si bazë ligjore me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi por se pa konkretizuar asnjë dispozitë konkrete që arsyetojnë veprimet ligjore të organit të punësimit.

Gjatë shqyrtimit të provave të lëndës respektivisht vlerësimit të testit me shkrim, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, përveç që ka konstatuar që nuk janë përdorur formulari Form.MAP-SHCK-07 ose formulari Form.MAP-SHCK-07a, ka vërejtur se në testin me shkrim për asnjë nga përgjigjet që kanë dhënë kandidatët, gjegjësisht ankuesi dhe kandidati i suksesshëm, Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil nuk ka përdorur pikët që kandidatët kanë marr për secilën pyetje dhe në bazë të testit me shkrim nuk mund të konstatohet se komisioni për secilën përgjigje a ka dhanë vlerësim të saktë për secilën përgjigje nga se mungon qelësi i pikëve të sakta dhe poashtu formulari MAP SHCK-09 është pa datë që është një elementë me rëndësi në procedurë të regrutimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas gjithë këtyre konstatimeve, vlerëson se procedura e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit Rajonal të Koordinimit në Prishtinë " e ka zhvilluar në kundërshtim me nenin 11 paragrafin 1, nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe dispozitave të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave,poashtu konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.2095 të datës 06.06.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 48,paragrafi 1 dhe 2 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku shprehimisht në paragrafin 2 të këtij neni thuhet: **2.Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij, Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë pretendimet ankimore të ankuesit duke vërtetuar në kundërshtim me gjendjen faktike dhe bazën juridike.**

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit"*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.243/2021, datë 29/04/2021

**Aydyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit,
- Kryeinspektorit të Inspektoriatit të Punës;
- Udhëheqësit të Personelit në Inspektoriatin e Punës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

